 - kodi i saj tatimor;
 - kapitali kryesor dhe kapitali i derdhur i Shoqërisë;
 - adresa e selisë;
 - një shënim që Shoqëria është në likuidim, nëse është i aplikueshëm.

Neni 3

Forma juridike

- 3.1 Shoqëria është krijuar në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në bazë të ligjit n. 9901, datë 14.04.2008 “Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare”, i ndryshuar (“Ligji për Shoqëritë Tregëtare”).
- 3.2 Shoqëria mund të transformohet në një formë tjetër ligjore në përputhje me legjislacionin shqiptar, me vendim që duhet marrë sipas nenit 13.

Neni 4

Baza ligjore

- 4.1 Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me Statutin, Ligjin për Shoqëritë Tregëtare dhe dispozita të tjera të legjislacionit shqiptar.

Neni 5

Kohëzgjatja

- 5.1 Shoqëria do ta zhvillojë aktivitetin e saj për një kohë të pacaktuar. Shoqëria do ta ndërpresë veprimtarinë e saj me likuidimin e aksioneve që zotërojnë aksionarët dhe ndarjen e pasurisë në varësi të miratimit të bilancit.

Firmosur nga: Andi Dragoj dhe Davide Patoletti

Deklaroj se përkthimi në gjuhën shqipe
është bërë sipas tekstit origjinal në gjuhën italiane.
Përkthyes Ligjore e Ministrisë së Drejtësisë
(Tel. 069 26 68 647)
Manjola SULAJ



Neni 6

Selia dhe Filialet

- 6.1 Selia e Shoqërisë është në Përmet, Zona Kadastrale 2917, n. pasurie 14/55 Shqipëri.
- 6.2 Administratori i Shoqërisë mund ta ndryshojë selinë e Shoqërisë si dhe të hapë adresa dytësore për Shoqërinë në Shqipëri, në përputhje me nevojat e Shoqërisë, nëpërmjet miratimit të asamblesë së përgjithshme në përputhje me nenin 13.
- 6.3 Mbledhja e aksionarëve mund të hapë ose të mbyllë agjenci, zyra përfaqësimi ose filiale që nuk kanë natyrë adresash dytësore jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me vendim dhe miratim të asamblesë së përgjithshme në përputhje me nenin 13.

Neni 7

Objekti

- 7.1 Objekti i shoqërisë është kryerja e aktiviteteve kulturore, rikrijuese, socio-sportive si në ujërat territoriale të Shqipërisë edhe në hapësirën tokësore të këtij shteti. Shoqëria mund të kryejë gjithashtu të gjitha veprimtaritë tregtare, industriale, të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme që konsiderohen të nevojshme ose të dobishme për arritjen e objektivit të shoqërisë, të ofrojë siguri dhe garanci reale ose personale, edhe në favor të palëve të treta, të përvetësojë aksione dhe interesa në shoqëri të tjera ose ndërmarrje, me kusht që këto veprime të mos kryhen në raport me publikun ose kryesisht, në përputhje me dispozitat detyruese të ligjit.
- Me vendim të asamblesë së përgjithshme, Shoqëria mund të bashkëpunojë me shoqëri të tjera rajonale ose të huaja për realizimin e projekteve tregtare të ngjashme me qëllimin social të shoqërisë, të cilat nuk duhet të jenë në kontrast me objektin social të Shoqërisë dhe me këtë statut dhe të mos kenë qëllime ose objekte të paligjshme.
- 7.2 Për të arritur qëllimin e lartpërmendur, Shoqëria mund:
- Të lidhë çfarëdolloj kontrate ose marrëveshje me persona fizikë ose juridikë, publikë ose privatë, të huaj ose shqiptarë, të ngjashëm me qëllimin social të shoqërisë dhe që të mos jetë në kontrast me objektin social të Shoqërisë dhe me këtë statut ose të mos ketë qëllim ose objekt të paligjshëm.
 - Të krijojë çfarëdolloj shoqërie ose të marrë pjesë në shoqëri shqiptare ose të huaja, joint venture (sipërmarrje të përbashkëta) ose lloje të ndryshme veprimtarish tregtare, që kanë objekte të njëjta ose të ngjashme;
 - Të hapë degë ose agjenci në Shqipëri ose jashtë saj;
 - Të përfaqësojë shoqëri shqiptare ose të huaja që lidhen me objektin e Shoqërisë;

Firmosar nga: Andi Dragoj dhe Davide Paoletti

Deklaroj se përkthimi në gjuhën shqipe
është bërë sipas tekstit origjinal në gjuhën italiane.
Përkthyes Ligjore e Ministrisë së Drejtësisë
(Tel. 069 26 68 647)
Manjola SULAJ




- e) Të lidhë marrëveshjeve për hua, të pranojë garanci personale ose të natyrave të tjera, të marë obligime;
 - f) Të ndërmarë çfarëdolloj aktiviteti tjetër tregëtar ose aktivitete të tjera dhe të kryejë çfarëdolloj veprimi ligjor ose transaksion që është drejtpërdrejt ose tërthorazi i lidhur me objektin e Shoqërisë, ose që synon drejtpërdrejt ose tërthorazi arritjen e objektit të Shoqërisë.
- 7.3 Shoqëria mund të kryejë, në rrugë dytësore, që gjithsesi synon arritjen e qëllimeve të Shoqërisë, çfarëdolloj veprimi dhe transaksioni tregëtar, industrial, financiar në lidhje me pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme që konsiderohen të nevojshme ose të përshtatshme për arritjen e qëllimeve të Shoqërisë.
- 7.4 Shoqëria mund të kryejë të gjitha aktivitetet dytësore, si dhe të gjitha aktivitetet e nevojshme dhe të përshtatshme për arritjen e objektit të Shoqërisë në përputhje me ligjin.
- 7.5 Objekti i Shoqërisë mund të modifikohet ose të ndryshohet me vendim të shumicës absolute të asamblesë së përgjithshme.

Neni 8

Kapitali

- 8.1 Kapitali themelues i Shoqërisë është 10,000 Lekë (dhjetë mijë Lekë) dhe është krijuar në datën e sotme nga 2 (dy) aksione. Secili prej Aksionarëve zotëron 1 (një) aksion me vlerë nominale proporcionale me kontributin e çdo Aksionari në kapitalin e Shoqërisë. Transferimi i mëvonshëm i aksionit të Aksionarëve në favor të një Aksionari tjetër ose në favor të palëve të treta nuk përbën modifikim të këtij Statuti.
- 8.2 Kapitali mund të derdhet me një ose më shumë këste brenda 1 (një) viti nga regjistrimi i Shoqërisë.
- 8.3 Në momentin e miratimit të këtij Statuti, aksionet ndahen ndërmjet Aksionarëve si më poshtë:

Aksionarët	# e aksioneve	përqindja	Vlera (lekë)
Z. Davide Paoletti	1	51%	5,100
InAlba Tour sh.p.k.	1	49%	4,900

- 8.4 Vendimi për rritjen e kapitalit të shoqërisë mund të lejojë kontributin e çdo elementi të prekshëm të vlerësimit ekonomik, duke përcaktuar modalitetet e kontributit; në mungesë të treguesve të ndryshëm kontributi duhet të bëhet në para.

Firmuar nga: Andi Draggj dhe Davide Paoletti

Deklaroj se përkthimi në gjuhën shqipe
është bërë sipas tekstit origjinal në gjuhën italiane,
Përkthyes Ligjore e Ministrisë së Drejtësisë
(Tel. 069 26 68 647)
Manjola SULAJ



Neni 9

Transferimi i aksioneve të kapitalit. Kufizimet e transferimit. Opsione.

- 9.1 Aksionarët e Shoqërisë nuk mund të shesin, transferojnë, dorëzojnë, dhurojnë, hipotekojnë, transferojnë pronësinë e zhveshur të pronës ose ta japin në përdorim, nuk mund të vënë si garanci të gjitha ose një pjesë të aksioneve të tyre që kanë në Shoqëri dhe nuk mund të lejojnë asnjë nga këto akte pa vendimin me shkrim të asamblesë së përgjithshme të miratuar në përputhje me këtë Statut. Sa më sipër nuk zbatohet për veprimet e kryera me ose në favor të Personave të Lidhur të secilit aksioner.

Neni 10

Rritja e kapitalit

- 10.1 Aksionarët mund të rrisin kontributin e tyre në kapitalin e Shoqërisë. Kontributet e anëtarëve mund të jetë në para ose në çfarëdolloj forme tjetër të lejuar nga ligji, duke përfshirë kontributet në natyrë me pasuri të luajtshme ose të paluajtshme. Për rastin e dytë, kontributi përmes pasurive të luajtshme ose të paluajtshme duhet të bëhet pas vlerësimit të tyre nëpërmjet ekspertimit. Për këtë qëllim, çdo aksionar ka të drejtë të emërojë ekspertin e vet. Nëse vlerësimet janë të ndryshme, do të caktohet një ekspert i tretë, shpenzimet për të cilin do të ndahen në mënyrë të barabartë midis të gjithë aksionarëve të cilët janë anëtarë të asamblesë në atë moment. Në të kundërt, kontributi nëpërmjet pasurive jomonetare duhet të vlerësohet në unanimitet nga anëtarët e asamblesë së përgjithshme.
- 10.2 Aksionarët mund të financojnë Shoqërinë nëpërmjet huave me interesa në normën ligjore të parashikuar ose pa interesa, ose në çfarëdolloj formë të lejuar nga ligji të ndryshme nga rritja e kapitalit, në rastin e fundit kërkohet miratimi me unanimitet i asamblesë së përgjithshme.
- 10.3 Modalitetet e rritjes së kapitalit, natyra e kontributeve dhe mënyrat e derdhjes së kontributeve nga Aksionarët, do të vendosen herë pas here me vendim të asamblesë së përgjithshme. Vendimet e asamblesë së përgjithshme në këtë rast mund të përfshijnë, midis të tjerave, sanksione dhe/ose pasoja për një aksionar në rast të mos pagimit të kontributit brenda afatit të caktuar, duke përfshirë por jo duke limituar (i) reduktimin e aksionit të aksionarit në kapital ose anulimin e rritjes (ii) së interesit për shkak të mospagesës etj.
- 10.4 Rritja e kapitalit mund të bëhet edhe nëpërmjet nënshkrimit dhe pagesës për aksione të reja të kapitalit nga aksionarët e rinj, me miratimin me shkrim nga asamblea e përgjithshme.

Firmosur nga: Andi Dragoj dhe Davide Paoletti

Deklaroj se përkthimi në gjuhën shqipe
është bërë sipas tekstit original në gjuhën italiane.

Përkthyes Ligjore e Ministrisë së Drejtësisë

(Tel. 069 26 68 647)

Manjola SULAJ




Neni 11

Reduktimi i kapitalit

- 11.1 Me vendim të asamblesë së përgjithshme, reduktimi i kapitalit do të bëhet në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

III. STRUKTURAT E MENAXHIMIT

Neni 12

Asamblea e përgjithshme

- 12.1 Vendimet kryesore për veprimtaritë e Shoqërisë merren nga asambleja e përgjithshme, e cila është organi më i lartë i Shoqërisë që ka të drejtë të marrë vendime për të gjitha çështjet e veprimtarisë së saj. Nëse Shoqëria ka ose ngelet me një Aksionar, dhe për sa kohë kjo situatë vazhdon, vendimet mund të merren nga ky i fundit me shkrim pa thirrur asamblenë e përgjithshme. Vendimet me shkrim të Aksionarit të Vetëm i komunikohen administratorit dhe shënohen në regjistrin e vendimeve.
- 12.2 Në rast se Shoqëria ka më shumë se një Aksionar, çdo aksion garanton të drejtën për një votë në përpjesëtim me vlerën e saj nominale në asamblenë e përgjithshme të aksionarëve dhe ushtrohet në bazë të këtij Statuti, e drejta për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur në organet drejtuese, e drejta për të marrë pjesë në shpërndarjen e fitimeve të Shoqërisë si dhe të drejta të tjera të parashikuara nga ky Statut, nga çdo marrëveshje e mundshme ndërmjet Aksionarëve dhe nga dispozitat ligjore të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.
- 12.3 Çdo transferim ose krijim i garancive për aksionet duhet të bëhet në përputhje me nenin 9 dhe/ose me miratimin të asamblesë së përgjithshme siç parashikohet në të.
- 12.4 Asambleja e përgjithshme ka të drejtë të vendosë për çështjet e mëposhtme:
- të modifikojë dhe të ndryshojë këtë Statut;
 - të pranojë aksionarë të rinj, kur është e zbatueshme (pas rritjes së kapitalit ose transferimit të aksioneve);
 - të rrisë ose të reduktojë kapitalin bazë;
 - të vendosë për shkrimin, shpërbërjen, likuidimin dhe për çdo lloj transformimi tjetër të Shoqërisë;
 - të miratojë blerjen dhe/ose shitjen e aksioneve në shoqëri shqiptare ose të huaja;
 - të japë garanci ose kolaterale, të miratojë garanci për hua dhe obligime ndaj palëve të treta;
 - të krijojë dhe/ose të pezullojë filiale dhe zyra përfaqësimi jashtë territorit shqiptar;

Firmuar nga: Andi Dragoj dhe Davide Paoletti

Deklaroj se përkthimi në gjuhën shqipe
është bërë sipas tekstit origjinal në gjuhën italiane.

Përkthuese Ligjore e Ministrisë së Drejtësisë
(Tel. 069 26 68 647)

Manjola SULAJ



- b. të miratojë raportet vjetore, bilanci dhe shpërndarjen e fitimeve;
- i. të miratojë rregulloren e administrimit të brendshëm;
- j. të ndërmarrë veprime ligjore kundrejt anëtarëve të organeve të Shoqërisë;
- k. të miratojë blerjen, shitjen dhe hipotekimin e pasurive të paluajtshme të Shoqërisë;
- l. çfarëdolloj transaksioni ndërmjet Shoqërisë dhe çfarëdolloj personi tjetër që përfaqëson Shoqërinë ose me Personat e Lidhur në lidhje me këtë person;
- m. të shktijë Shoqërinë;
- n. të emërojë dhe të revokojë administratorin/administratorët;
- o. të miratojë rrogën e administratorit/administratorëve;
- p. të miratojë ekspertët kontabël të kualifikuar dhe shpërblimin përkatës;
- q. të organizojë strukturën e Shoqërisë;
- r. të përcaktojë buxhetin vjetor;
- s. të miratojë çdo vendim tjetër për zgjidhjen e çështjeve që i takojnë asamblesë së përgjithshme, në bazë të ligjit dhe/ose në bazë të këtij Statuti.

Neni 13

Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme

- 13.1 Asamblea e zakonshme në thirrjen e saj të parë, konsiderohet e vlefshme nëse janë të pranishëm aksionarët që përbëjnë gjysmën e votave të përgjithshme; Në thirrjen e dytë, ajo është e vlefshme, pavarësisht nga numri i aksionarëve të pranishëm. Nëse kalon gjysëm ore nga orari i caktuar për mbledhjen e asamblesë dhe nuk ka kuorum, mbledhja duhet të shtyhet pas një jave në të njëjtën ditë, në të njëjtën orë dhe në të njëjtin vend ose në një datë të mëvonshme nëse kjo specifikohet në njoftimin e thirrjes së asamblesë së përgjithshme, përveç rasteve kur aksionarët bien dakord ndryshe.
- 13.2 Vendimet që kanë të bëjnë me modifikimin e këtij Statuti, ritjen dhe reduktimin e kapitalit, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe shkrirjen e Shoqërisë kërkojnë në çdo rast shumicën e cilësuar me të paktën 3/4 e votave të Aksionarëve të pranishëm në asamble dhe duhet në çdo rast të miratohen nga Aksionari i Pakicës. Me përjashtim të rasteve kur Ligji për Shoqëritë Tregtare nuk lejon modifikimin statutor nga shumica e nevojshme për marrjen e vendimeve, të gjitha vendimet e tjera të asamblesë së përgjithshme mund të miratohen nga një shumicë e thjeshtë e aksionarëve të pranishëm ose të përfaqësuar në asamble, por në çdo rast vetëm nëse kanë miratimin e Aksionarit të Pakicës. Për të shmangur keqkuptimet, nëse Aksionari i Shumicës nuk i miraton vendimet e përmendura më sipër ose voton kundër tyre në asamble ose nuk i miraton shprehimisht duke hequr dorë nga e drejta e pjesëmarrjes në asamble, vendimet nuk konsiderohen të vlefshme dhe nuk do të ketë asnjë vlerë ligjore për Shoqërinë, Aksionarët ose për palët e treta.

Firmosor nga: Andi Drangj dhe Davide Paoletti

Deklaroj se përkthimi në gjuhën shqipe
është bërë sipas tekstit origjinal në gjuhën italiane,
Përkthyes Ligjore e Ministrisë së Drejtësisë
(Tel. 069 26 68 647)

Manjola SULAJ




- 13.3 Kur asambleja e përgjithshme nuk mbledhet sipas të nenit 14 të këtij Statuti, ajo mund të marrë vendime vetëm nëse të gjithë anëtarët e Shoqërisë janë të pranishëm në asamble dhe marrin përsipër të vazhdojnë, pavarësisht nga parregullsia. Parregullsitë e mbledhjes do të raportohen në procesverbal.
- 13.4 Aksionarët pranojnë dhe bien dakord të marrin vendime me shkrim në emër të Shoqërisë. Vendimet e propozuara, së bashku me dokumentacionin që mbështet vendimet, duhet t'i dërgohen Aksionarëve në përputhje me paragrafin 14.4. Aksionarët marrin vendim për vendimet e propozuara brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendrike nga data e njoftimit të dokumentit, i cili përmban tekstin e vendimeve, duke i kthyer Aksionarit tjetër dhe duke njoftuar Administratorin e Shoqërisë, brenda këtij afati kohor, një kopje origjinale të nënshkruar të dokumentit ose duke dërguar me e-mail një kopje të skanuar të dokumentit të nënshkruar. Për këtë qëllim, të gjithë Aksionarët mund të nënshkruajnë kopje të veçanta por identike të dokumentit që përmban tekstin e vendimeve të propozuara.
- 13.5 Aksionarët mund të miratojnë një vendim me shkrim në mungesë të formaliteteve të përcaktuara në paragrafin 13.4 me kusht që të gjithë Aksionarët të jenë dakord për miratimin e këtij vendimi. Për këtë qëllim, të gjithë aksionarët mund të nënshkruajnë vendime të veçanta por identike, nga të cilat një kopje e firmosur në origjinal duhet t'u dërgohet atyre dhe të ruhet nga Shoqëria.
- 13.6 Aksionarët marrin përsipër të veprojnë në mirëbesim dhe të shmangin sa më shumë të jetë e mundur rastet e Bllokimeve. Në rast se ndodh një situatë Bllokimi, Aksionarët, me qëllim funksionimin normal të Shoqërisë, janë të detyruar dhe janë personalisht përgjegjës ndaj njëri-tjetrit dhe/ose Shoqërisë të kryejnë ose të mos të kryejnë veprimet minimale në mënyrë që Shoqëria të ruajë status-quo^o, përveç rasteve kur ruajtja e status-quo^o sjell dëm të drejtpërdrejtë ose një përgjegjësi qartësisht të konstatueshme që dëmton Shoqërinë.

Neni 14

Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme


- 14.1 Asambleja e përgjithshme mund të thirret nga Administratori i Shoqërisë, të paktën një herë në vit në selinë e Shoqërisë ose në një vend tjetër sipas shënimit të njoftimit të mbledhjes. Asambleja mund të mbledhet edhe jashtë selisë së shoqërisë, me kusht që të jetë në territorin e Shqipërisë ose të Italisë. Në rast se mbledhja bëhet me mjete elektronike, mbledhja e asamblesë do të konsiderohet e zhvilluar në territorin shqiptar.
- 14.2 Aksionarët që përfaqësojnë të paktën 5% të votave të përgjithshme të Shoqërisë mund t'i kërkojnë me shkrim Administratorit, por edhe me e-mail, të thërrasë asamblenë e përgjithshme. Kërkesa duhet të përmbajë arsyet, objektivat dhe çështjet për të cilat asambleja e aksionarëve duhet të vendosë. Administratori është i detyruar të thërrasë asamblenë e

Firmosur nga: Andi Dragoj dhe Davide Paoletti

Deklaroj se përkthimi në gjuhën shqipe
është bërë sipas tekstit origjinal në gjuhën italiane.

Përkthyes Ligjore e Ministrisë së Drejtësisë
(Tel. 069 26 68 647)

Manjola SULAJ



përgjithshme në përputhje me nenin 84 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare (duke dërguar njoftimin për mbledhje edhe me postë elektronike), në të kundërt aksionarët që kanë kërkuar thirrjen kanë të drejtë të thërrasin asambleenë e përgjithshme në përputhje me detyrimet e njoftimit të përcaktuara në paragrafin 14.3 të këtij statuti.

14.3 Asambleja e përgjithshme duhet të thirret me njoftim me shkrim të lëshuar nga Administratori, i cili do t'u dërgohet Aksionarëve ose përfaqësuesve të Aksionarëve me postë rekomande me njoftim për marrjen ose me postë elektronike (e-mail) jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë para datës së caktuar për mbledhjen. Njoftimi për thirrjen e asamblesë së përgjithshme duhet të përmbajë ditën, orën dhe vendin e mbledhjes, si dhe çështjet që do të diskutohen (rendi i ditës) dhe, në rastin e mbledhjeve vjetore për miratimin e bilancit, duhet të përmbajë edhe pasqyrat e plota financiare bashkë me raportet e mundshme të auditimit. Në njoftimin e thirrjes mund të parashikohet një datë tjetër për thirrjen e dytë, në rast se mbledhja e parashikuar në thirrjen e parë nuk rezulton ligjërisht e rregullt, por gjithsesi edhe për thirrjen e dytë do të kërkohet shumica e parashikuar në thirrjen e parë.

14.4 Aksionarët duhet t'i japin administratorit të Shoqërisë të dhënat e plota të kontaktit, përfshirë adresën poSAILINGe dhe adresën e e-mail^ë. Gjithashtu, ata duhet ta njoftojnë Administratorin për çdo ndryshim të mëvonshëm të të dhënave të tyre të kontaktit.

14.4.1 Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe, një njoftim i bërë sipas ose në lidhje me këtë Statut:

- i. do të jetë i shkruar në gjuhën angleze ose italiane dhe sipas rastit do të përkthehet në shqip;
- ii. duhet të firmoset nga ai ose në emër të atij që e lëshon;
- iii. do t'i dërgohet palës së interesuar në adresën e specifikuar në përputhje me paragrafin 14.4.2, ose në një adresë tjetër të dorëzuar nga pala e interesuar në përputhje me dispozitat e këtij neni 14;
- iv. duhet:
 - të dorëzohet dorazi;
 - të dërgohet me postë rekomande me njoftim për marrjen ose me postë ekspres;
 - të dërgohet me e-mail me konfirmim për marrjen;
- v. konsiderohet i marrë siç përcaktohet në paragrafin 14.4.4.

14.4.2 Adresat ku duhet të dërgohen njoftimet janë si më poshtë:

Për Davide Paoletti

Adresa: Romë, via Camillo Spinedi 1, kodi poSAILING 00189

e-mail: davide.paoletti@gmail.com

Për InAlba Tour sh.p.k.

Firmuar nga: Andi Dragaj dhe Davide Paoletti

Deklaroj se përkthimi në gjuhën shqipe është bërë sipas tekstit origjinal në gjuhën italiane.

Përkthyes Ligjore e Ministrisë së Drejtësisë

(Tel. 069 26 68 647)

Manjola SULAJ



Adresa: Gjirokastrë, Përmet PËRMET, Lagja Varrosh, Rr. 13 Shtatori, Zona kadastrale 2917

e-mail: info@inalbatour.com

14.4.3 Një Aksonar mund të ndryshojë të dhënat e kontaktit ku duhet të marrë njoftimet, siç përcaktohet në paragrafin 14.4.2, por duhet t'ia komunikojë ato Aksionarit tjetër dhe Shoqërisë. Çdo ndryshim i mundshëm, i komunikuar në përputhje me paragrafin 14.4.3 të këtij statuti, do të zbatohet nga ora 9:00 deri:

- i. në datën (e mundshme) të specifikuar në njoftim si data e hyrjes në fuqi të ndryshimit;
- ii. në pesë ditë pune nga marrja e komunikimit.

14.4.4 Njoftimi do të konsiderohet i kryer:

- i. nëse dorëzohet dorazi, duke e firmosur njoftimin e thirrjes dhe/ose dokumentet e tjera që shërbejnë për këtë qëllim;
- ii. nëse dërgohet me postë rekomandë me njoftim për marrjen ose me postë ekspres, duke firmosur vërtetimin e marrjes që përmban gjithashtu edhe orën kur njoftimi është lënë në adresë ose shënohet ora 16:00 e ditës kur postieri nuk ka mundur të dorëzojë njoftimin dhe ka njoftuar se Aksionari është larguar, adresa nuk ekziston etj.;
- iii. nëse dërgohet me e-mail, duhet të konfirmohet marrja e e-mail'.

14.5 Secili prej aksionarëve ka të drejtë të përfaqësohet nga një person tjetër sipas nenit 85 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

Neni 15

Zhvillimi i mbledhjes

- 15.1 Asambleja e përgjithshme do të drejtohet nga administratori i vetëm, dhe në mungesë të tij, nga një person i caktuar nga pjesëmarrësit e pranishëm në mbledhje që përfaqësojnë shumicën e kapitalit të shoqërisë. Asambleja e aksionarëve mund të zhvillohet edhe në disa vende njëkohësisht, të lidhur me audio konferencë ose videokonferencë (p.sh. me Skype, Viber, WhatsApp, Zoom, Microsoft teams, etj.), dhe kjo do të bëhet duke respektuar kushtet e mëposhtme, të cilat duhet të shënohen edhe në procesverbal:
- drejtuesi dhe sekretari i mbledhjes duhet të jenë të pranishëm në njëjtin vend dhe duhet të kujdesen për përgatitjen dhe nënshkrimin e procesverbalit;
 - drejtuesi i mbledhjes duhet të verifikojë identitetin dhe legjitimitetin e të pranishmëve, të rregullojë ecurinë e mbledhjes, të konstatojë dhe të shpallë rezultatet e votimit;
 - personi që mban procesverbalin duhet të pasqyrojë në mënyrë të përshtatshme ngjarjet e mbledhjes të cilat duhet të jenë objekt i procesverbalit;

Firmosur nga: Audi Draggi dhe Davide Paoletti

Deklaroj se përkthimi në gjuhën shqipe
është bërë sipas tekstit origjinal në gjuhën italiane,
Përkthyes Ligjore e Ministrisë së Drejtësisë
(Tel. 069 26 68 647)

Manjola SULAJ




- pjesëmarrësit duhet të lejohen të marrin pjesë në diskutim dhe të votojnë njëkohësisht për çështjet e rendit të ditës, si dhe të lexojnë, të marrin ose të transmetojnë dokumente;
 - në njoftimin e mbledhjes duhet të përcaktohen (përveç rasteve të asamblesë totalitare) vendet e lidhura në audiokonferencë ose videokonferencë nën kujdesin e shoqërisë, në të cilët anëtarët mund të shkojnë për të marrë pjesë në mbledhje, duke e konsideruar mbledhjen të mbajtur në vendin ku janë të pranishëm drejtuesi i mbledhjes dhe sekretari. Në rastet kur parashikohet apo kërkohet praninë e një Noteri, vendi i zhvillimit të mbledhjes do të jetë Shqipëria. Në këtë rast, të gjitha dispozitat e mësipërme do të interpretohen me mirëkuptim të përbashkët.
- 15.2 Procesverbali do të mbahet nga një noter publik shqiptar, i zgjedhur nga drejtuesi i mbledhjes, në rast se kjo kërkohet nga ligji në fuqi dhe/ose kur një nga aksionarët e gjykon të arsyeshme. Në këtë rast nuk është i nevojshëm shërbimi i sekretarit.
- 15.3 Procesverbali i mbledhjes duhet të nënshkruhet nga drejtuesi i mbledhjes dhe nga sekretari (ose nga një noter). Në rast se nuk është e mundur hartimi dhe nënshkrimi i ekstraktit të procesverbalit, që përmban vendimet e miratuara, menjëherë pas mbylljes së mbledhjes, kjo rrethanë do të përshkruhet në procesverbalin e mbledhjes dhe hartimi i tij do të bëhet nga drejtuesi i mbledhjes dhe procesverbali përfundimtar duhet t'u dërgohet aksionarëve të pranishëm në mbledhje me e-mail brenda 3 (tre) ditëve pune nga data e mbledhjes. Të gjithë aksionarët e pranishëm në mbledhje mund të nënshkruajnë kopje të veçanta por identike të procesverbalit dhe vendimeve, kopja origjinale e nënshkruar nga secili duhet t'i dërgohet administratorit të shoqërisë jo më vonë se 7 (shtatë) ditë pune nga marrja e drafrit. Nëse administratori nuk ka mbledhur firmat e të gjithë aksionarëve të pranishëm në mbledhje brenda afatit të përcaktuar më sipër, administratori është i autorizuar të deponojë në Qendrën Kombëtare të Biznesit ekstraktin e procesverbalit që përmban vendimet e miratuara dhe nënshkrimet e rregullta të drejtuesit të mbledhjes dhe sekretarit të cilët përcaktojnë formimin e kuorumit, shumicën e nevojshme që vendimet të jenë të vlefshme dhe votën e secilit aksionar.
- 15.4 Pa kundërshtuar çka përcaktohet më sipër në paragrafin 15.3, ekstraktet e vendimeve të miratuara nga asambleja e përgjithshme mund të veçohen nga procesverbali për qëllime të depozitimit të tyre në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe të nënshkruhen në mënyrë të rregullt nga të gjithë aksionarët e pranishëm dhe secilit do t'i jepet një kopje. Vota "kundër" dhe nënshkrimi i Aksionarit (ose Aksionarëve) "kundër" mund të shënohen në vendimet e miratuara në mbledhje; megjithatë, në rast se Aksionari refuzon të nënshkruajë, ky refuzim do të shënohet nga drejtuesi i mbledhjes pranë emrit të aksionarit.
- 15.5 Aksionarët që refuzojnë të kryejnë aktet procedurale të përcaktuara në këtë Statut, pa paragjykuar të drejtën e tyre për të votuar "kundër" vendimeve të propozuara, ose që nuk marrin pjesë në mbledhje, janë përgjegjës ndaj aksionarit tjetër (ose aksionarëve) dhe/ose

Firmuar nga: Andi Dragaj dhe Davide Paoletti

Deklaroj se përkthimi në gjuhën shqipe
është bërë sipas tekstit original në gjuhën italiane.
Përkthyes Ligjore e Ministrisë së Drejtësisë
(Tel. 069 26 68 647)
Manjola SULAJ



MANJOLA SULAJ

Shoqërisë dhe, nëse është rasti, ata janë të detyruar të kompensojnë dëmin e shkaktuar nga sjellja e tyre e cila do të konsiderohet në keqbesim. Për të shmangur keqkuptimet, konsiderohet se Aksionari është në shkelje të Statutit nëse refuzon të nënshkruajë formalisht vendimin kur vota e tij "kundër" është shënuar në mënyrë të rregullt në vendim.

Neni 16

Përfshirimi nga e drejta e votës

- 16.1 Aksionari nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse Asambleja e Përgjithshme vendos:
- të vlerësojë veprimtarinë e tij;
 - të anulojë çfarëdolloj obligim në ngarkim të tij;
 - ta padisë në emër të Shoqërisë;
 - t'i japë atij përfitime të tjera;
- si dhe në çdo rast tjetër të parashikuar në Ligjin për Shoqëritë Tregtare.
- 16.2 Kur Aksionari përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, përfaqësuesi i tij konsiderohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi si Aksionari që ai përfaqëson.

Neni 17

Tërheqja dhe përjashtimi i partnerit

- 17.1 Tërheqja e Aksionarit rregullohet nga neni 101 i Ligjit për Shoqëritë Tregtare.
- 17.2 Aksionari që dëshiron të tërhiqet nga Shoqëria duhet të njoftojë me shkrim Administratorin për qëllimin e tërheqjes dhe arsyet e tërheqjes.
- 17.3 Administratori, menjëherë pas marrjes së njoftimit sipas paragrafit 17.2 të këtij neni, duhet të thërrasë asamblenë e përgjithshme për të vendosur nëse Aksionari do të marrë kompensimin për aksionet e tij pas tërheqjes për motive të arsyeshme.
- 17.4 Asambleja do të diskutojë shkaqet e tërheqjes të paraqitura nga Aksionari që dëshiron të tërhiqet dhe do të vendosë nëse shkaqet e tërheqjes janë të arsyeshme, shumën dhe mënyrat e pagesës së aksioneve të Aksionarit që dëshiron të tërhiqet. Aksionari që tërhiqet mund të fillojë një procedim pranë gjykatës kompetente për t'i kërkuar Shoqërisë likuidimin e aksioneve në rast se Administratori nuk thërret asamblenë ose nëse kjo e fundit nuk i njeh shkaqet e tërheqjes dhe të drejtën e tij për t'u kompensuar.
- 17.5 Nëse asambleja e përgjithshme nuk thirret vullnetarisht ose për shkak të mungesës së kuorumit brenda afatit prej 30 ditësh nga data kur Administratori ka marrë njoftimin e synimit për t'u tërhequr ose nëse nuk i pranon shkaqet e tërheqjes si të arsyeshme, pra duke mohuar të drejtën e Aksionarit për t'u kompensuar, Aksionari që dëshiron të tërhiqet mund:

Firmosur nga: Andi Draggj dhe Davide Paoletti

Deklaroj se përkthimi në gjuhën shqipe
është bërë sipas tekstit origjinal në gjuhën italiane.
Përkthuese Ligjore e Ministrisë së Drejtësisë
(Tel. 069 26 68 647)

Manjola SULAJ




- a. Të ushtrojë të drejtën e tërheqjes duke ia komunikuar Administratorit të Shoqërisë në selinë e Shoqërisë, me komunikim me shkrim, brenda 30 ditëve nga skadenca e afatit të përcaktuar në këtë nen. Në këtë rast, tërheqja do të konsiderohet efektive duke filluar nga data e marrjes së komunikimit me shkrim, pavarësisht nga fakti nëse aksionet janë likuiduar apo jo, dhe Administratori duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për ta regjistruar këtë tërheqje në Qendrën Kombëtare të Biznesit në përputhje me ligjin;

dhe/ose

- b. Të fillojë një procedim në gjykatën kompetente sipas paragrafit 17.4. Në këtë rast, tërheqja do të konsiderohet efektive duke filluar nga data e vendimit përfundimtar të gjykatës për këtë çështje.

17.6 Aksionari mund të përjashtohet nga Shoqëria vetëm për shkaqe të arsyeshme në përputhje me nenin 102 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

Neni 18

Administrimi dhe Përfaqësimi

- 18.1 Shoqëria do të administrohet në aktivitetin e saj të përditshëm nga një ose më shumë Administratorë të emëruar dhe të zëvendësuar nga asambleja e përgjithshme.
- 18.2 Administratorët mund të emërohen për një periudhë maksimale prej 5 (pesë) vitesh me mundësi rinovimi.
- 18.3 Administratori nuk duhet të jetë detyrimisht një nga Aksionarët. Të dhënat individuale të Administratorëve janë përcaktuar në Shtojcën A.
- 18.4 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë Statut ose me vendim të asamblesë së përgjithshme për emërimin e tyre, Administratorët, kur Shoqëria ka më shumë se një Administrator, kanë kompetenca të plota të cilat ushtrohen së bashku për administrimin e zakonshëm dhe të përditshëm të Shoqërisë, të cilat janë renditur në mënyrë jo shteruese si më poshtë:
- administrimi i aktivitetit të përditshëm të Shoqërisë në përputhje me vendimet dhe udhëzimet e asamblesë së përgjithshme, që merren herë pas here;
 - të hapë, të mbyllë dhe të menaxhojë llogaritë bankare të Shoqërisë;
 - të miratojë përmbylljen e marrëveshjeve ose të bëjë transaksione me palë të treta;
 - të zbatojë, të përgatisë oferta dhe/ose dokumente, të bëjë dorëzimin e tyre, të bëjë ankime dhe të ndjekë procedurat e prokurimit;
 - të mbajë regjistrat kontabël në përputhje me ligjin dhe standartet e kontabilitetit;

Firmuar nga: Andi Dragaj dhe Daniele Paoletti

Deklaroj se përkthimi në gjuhën shqipe është bërë sipas tekstit original në gjuhën italiane.

Përkthyes Ligjore e Ministrisë së Drejtësisë

(Tel. 069 26 68 647)

Manjola SULAJ




- të përgatisë bilancin vjetor të Shoqërisë dhe të bëjë kontrollin e tij me revizorë të jashtëm, nëse ka, për miratimin e tij nga asambleja e përgjithshme;
- të koordinojë dhe të drejtojë departamentet me qëllim funksionimin optimal të Shoqërisë;
- të administrojë punën e departamenteve, drejtpërdrejt ose me delegim dhe/ose të ndajë përgjegjësitë e punonjësve;
- të punësojë dhe të shlepë marrëdhëniet e punës së punonjësve të Shoqërisë;
- të ndajë përgjegjësitë dhe detyrat e punonjësve të Shoqërisë;
- të marrë vendime për shkeljet e disiplinës në punë, për shkeljet e detyrave në punë dhe për përgjegjësitë e punonjësve për kryerjen e detyrave të caktuara, në përputhje me ligjin dhe rregullore të tjera;
- të kryejë çfarëdo veprimtarie tjetër të përcaktuar nga ligji, nga ky Statut dhe nga rregullore të tjera, nëse ka.

Miratimi nga çdo Administrator mund të bëhet me shkrim, por mund të bëhet edhe me e-mail, nënshkrimi bashkë me dokumentin/aktin, ekzekutimi bashkë me veprimet nëse është e mundur për aq sa e lejon teknologjia (e-banking apo procedura të ngjashme) ose me vendim të përbashkët të tyre.

- 18.5 Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga ky Statut, Administratorët, në rast se Shoqëria ka më shumë se një Administrator, janë të autorizuar të përfaqësojnë shoqërinë bashkërisht në të gjitha veprimet me palët e treta, institucionet private dhe publike. Miratimi nga çdo Administratori mund të bëhet me shkrim, por mund të bëhet edhe me e-mail, nënshkrimi bashkë me dokumentin/aktin, ekzekutimi bashkë me veprimet nëse është e mundur për aq sa e lejon teknologjia (e-banking apo procedura të ngjashme) ose me vendim të përbashkët të tyre.
- 18.6 Në kryerjen e detyrave të tij, Administratori (Administratorët) duhet të përdorë aftësitë e një biznesmeni të besueshëm dhe të respektojë konfidencialitetin e çështjeve të rezervuara.
- 18.7 Administratorët mund të autorizojnë me delegim palë të treta ose Administratorë të tjerë që të kryejnë veprime dhe/ose të ushtrojnë, të gjitha ose pjesërisht për llogari të tyre dhe interesin e tyre, detyrat e Administratorit të përcaktuara sipas këtij Statuti ose sipas vendimeve të asamblesë së përgjithshme. Për të shmangur keqkuptimet, autorizimi i çdo Administratori mund të bëhet në favor të të njëjtit person ose të një Administratori.
- 18.8 Për të shmangur keqkuptimet, kompetencat dhe mënyrat e përfaqësimit të Administratorëve dhe Shtojca A mund të ndryshohen me vendim të asamblesë së përgjithshme, pa qenë e nevojshme të vendoset për ndryshimin e Statutit të Shoqërisë. Në situata të jashtëzakonshme, Aksionarët bien dakord që personi në cilësinë e Administratorit i

Firmosur nga: Andi Dragaj dhe Davide Paoletti

Deklaroj se përkthimi në gjuhën shqipe
është bërë sipas tekstit origjinal në gjuhën italiane.
Përkthyesë Ligjore e Ministrisë së Drejtësisë
(Tel. 069 26 68 647)
Manjola SULAJ

përcaktuar në Shtojcën A nuk mund të hiqet para se të kenë kaluar 4 vite nga momenti i themelimit të Shoqërisë.

Neni 19

Bilanci dhe fitimet

- 19.1 - Aktivitetet financiare mbyllen më 31 dhjetor të çdo viti. Organi administrativ kujdeset për përgatitjen e bilancit dhe ua prezanton aksionarëve për miratim brenda njëqind e njëzet ditëve nga përfundimi i aktivitetit të shoqërisë. Bilanci mund t'u prezantohet aksionarëve për miratim brenda njëqind e tetëdhjetë ditëve nga përfundimi i aktivitetit të shoqërisë, atëherë kur, sipas gjykimit të organit administrativ, ekziston nevoja e kërkesave të veçanta që kanë të bëjnë me strukturën dhe me objektin e shoqërisë.
- 19.2 - Nga të ardhurat neto të ushtrimit të aktiviteteve duhet të zbritet një shumë që korrespondon me të paktën 5% të tyre, e cila do të jetë e destinuar për rezervën ligjore, derisa kjo të ketë arritur një të pestën e kapitalit të shoqërisë. Pjesa e mbetur e të ardhurave nga ushtrimi i aktiviteteve u shpërndahet aksionarëve, përveç rasteve kur ata vendosin ndryshe.

Neni 20

Titujt e debisë

- 20.1 - Shoqëria mund të emetojë tituj debie, në përputhje me sa parashikohet nga ligji, pas vendimit të marë me vota në favor nga aksionarët që përfaqësojnë më shumë se gjysmën e kapitalit të shoqërisë.

Neni 21

Detyrimet e Besnikërisë dhe Përgjegjësitë

- 20.1 - Përveç detyrimeve të përgjithshme të parimit të besnikërisë të parashikuara nga nenet 14, 15, 17 dhe 18 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, Administratori duhet:
- të kryejë detyrat e tij në mirëbesim në përputhje me Ligjin për Shoqërive Tregtare ose me këtë Statut, të ketë parasysh interesat e Shoqërisë në përgjithësi dhe në veçanti duke marrë në konsideratë edhe ndikimin mjedisor të veprimtarisë së saj;
 - të ushtrojë funksionet që i janë besuar në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare ose me këtë Statut, vetëm për qëllimet e përcaktuara në këtë Statut;
 - të konsiderojë në mënyrë të përshtatshme çështjet për të cilat duhet të merret vendim;
 - të parandalojë dhe të shmangë konfliktet ekzistuese dhe të mundshme ndërmjet interesave personale dhe atyre të Shoqërisë;

Firmuar nga: Andi Dragoj dhe Davide Paoletti

Deklaroj se përkthimi në gjuhën shqipe
është bërë sipas tekstit origjinal në gjuhën italiane.

Përkthuese Ligjore e Ministrisë së Drejtësisë

(Tel. 069 26 68 647)

Manjola SULAJ




- e. të ushtrojë funksionet e tij sipas parimit të aftësisë dhe profesionalizmit;
- f. të pajisë me çfarëdolloj informacioni në lidhje me biznesin dhe të dhënat ekonomike të Shoqërisë secilin prej Aksionarëve kur ata e kërkojnë, brenda një afati kohor të përshtatshëm dhe në çdo rast jo më vonë se 7 ditë. Informacioni dhe të dhënat duhet të jenë të përditësuara.
- 21.2 Administratori, gjatë ushtrimit të detyrave të tij, do të jetë përgjegjës kundrejt Shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim që lidhet me objektin e Shoqërisë, me përjashtim të rasteve kur në bazë të analizës dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është bërë me mirëbesim.
- 21.3 Në rast të shkeljes së detyrimeve dhe normave të aftësisë të përmendura në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, Administratori është i detyruar të dëmshpërblejë Shoqërinë për çdo dëm që rrjedh nga një shkelje e tillë. Ai/ajo gjithashtu duhet të dorëzojë përfitimet e mundshme të mara nga vetë ai/ajo ose nga Personat e Lidhur gjatë mospërbushjes së detyrimeve të tij/saj. Ai/ajo do të mbajë barrën e provës për të vërtetuar nëse kryerja e detyrave të tij/të saj është bërë sipas standardeve të kërkuara.
- 21.4 Në veçanti, por jo vetëm, Administratori është i detyruar të dëmshpërblejë Shoqërinë në lidhje me dëmin e shkaktuar, nëse, në kundërshtim me sa parashikohet nga Ligji për Shoqëritë Tregtare, kryen veprimet e mëposhtme:
- ç'u kthejë kontributet aksionarëve;
 - ç'u paguajë interesa ose dividendë aksionarëve;
 - të shpërndarë pasuritë e Shoqërisë;
 - të lejojë Shoqërisë vazhdimin e aktivitetin e saj tregtar, kur në bazë të situatës financiare duhet të kishte parashikuar që shoqëria nuk kishte mundësi për të shlyer detyrimet e saj;
 - të japë kredi/hua.
- 21.5 Neni 92, paragrafi 6, i Ligjit për Shoqëritë Tregtare zbatohet edhe për ankesat, që rrjedhin nga paragrafët e këtij neni. Të tilla ankesa duhet të bëhen brenda 3 viteve nga kryerja e shkeljes ose zbulimi i saj.

IV. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 22

Eksperti kontabël i autorizuar.

- 22.1 Eksperti ose ekspertët kontabël do të emërohen me vendim të asamblesë së përgjithshme, nëse është e nevojshme ose është e detyrueshme nga ligji.

Firmuar nga: Andi Dragoj dhe Davide Paoletti

Deklaroj se përkthimi në gjuhën shqipe
është bërë sipas tekstit origjinal në gjuhën italiane.

Përkthyes Ligjore e Ministrisë së Drejtësisë

(Tel. 069 26 68 647)

Manjola SULAJ




Neni 23

Dividentët dhe fitimet

- 23.1 Aksionarët kanë të drejtë të marrin një pjesë të fitimeve të pasqyruara në bilancin e Shoqërisë që duhet të ndahen sipas dispozitave të këtij Statuti dhe sipas dispozitave të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

Neni 24

Viti financiar

- 24.1 Viti financiar i aktivitetit të Shoqërisë përkon me vitin kalendarik, i cili fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor të çdo viti.

Neni 25

Bilanci. Mbjajtja e llogarive

- 25.1 Bilanci i Shoqërisë miratohet nga asambleja e përgjithshme dhe duhet të përgatitet për t'u paraqitur në organet fiskale brenda fundit të marsit të vitit pasardhës.
- 25.2 Regjistrat e llogarive duhet të mbahen në gjuhën italiane dhe në gjuhën shqipe, në valutën vendase (Lekë). Shoqëria mund të mbajë llogari të veçanta në valutë të huaj, shuma e të cilave duhet të konvertohet në valutën vendase çdo muaj.
- 25.3 Shoqëria mund të marrë financime nga institucione financiare që operojnë në Shqipëri ose jashtë saj. Për këtë arsye, Aksionarët dhe/ose Shoqëria mund të krijojnë garanci sigurimi, ose hipoteka mbi pasuritë e huajtshme ose të paluajtshme, me vendim të asamblesë së përgjithshme në përputhje me dispozitat e këtij Statuti.

Neni 26

Likuidimi

- 26.1 Asambleja e përgjithshme mund të vendosë për likuidimin e Shoqërisë në përputhje me nenin 13.
- 26.2 Me vendim të asamblesë së përgjithshme, do të emërohet një likuidues ose një grup likuiduesish të cilët duhet të kujdesen për procedurat e likuidimit.
- 26.3 Likuiduesi (ose likuiduesit) duhet të hartojë raportin e likuidimit, i cili duhet të përmbajë një përmbledhje të gjendjes ekonomike të shoqërisë, fazat e likuidimit dhe kohën e nevojshme për përfundimin e tij. Në përfundim të këtij procesi, asambleja e aksionarëve do të miratojë bilancin përfundimtar dhe do të nisë mbylljen e procedurave të likuidimit.

Vizmosur nga: Andi Dragoj dhe Davide Paoletti

Deklaroj se përkthimi në gjuhën shqipe është bërë sipas tekstit original në gjuhën italiane.

Përkthyes Ligjore e Ministrisë së Drejtësisë

(Tel. 069 26 68 647)

Manjola SULAJ



Neni 27

Modifikimi i Statutit

- 27.1 - Dispozitat e këtij Statuti mund të modifikohen nga asambleja e përgjithshme, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare dhe me këtë Statut. Modifikimi, me vendim të asamblesë së përgjithshme, i të dhënave, përmbajtjes ose dispozitave të neneve 6.1, 7.1, 8, 14.4.2, 18.4, 18.5 ose të Shtojcës A nuk do të konsiderohen si modifikime të këtij Statuti.

Neni 28

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 28.1 - Të gjitha mosmarrëveshjet që lindin midis aksionarëve ose midis aksionarëve dhe shoqërisë, administratorëve, likuiduesve ose revizorëve, që kanë si objekt të drejtat e disponueshme në lidhje me marrëdhëniet me shoqërinë, zgjidhen nga Gjykata kompetente pranë selisë së Shoqërisë.

Neni 29

Dispozita përfundimtare

- 29.1 Ky Statut është hartuar dhe nënshkruar në dy kopje origjinale në gjuhën italiane.

Nënshkruar më 06.04.2023

AKSIONARËT

Davide Paoletti

firma

InAlba Tour sh.p.k

Andi Dragoj

firma

SHTOJCA A

Administratori i Shoqërisë

1. Z. ARBER GOGA, shtetas SHQIPTAR, lindur më 06.12.1983 në MEMALIAJ, me dokument identifikimi n. 032935773, me numër personal I30612021T, emëruar për një periudhë 5 (pesë);

Firmuar nga: Andi Dragoj dhe Davide Paoletti

Deklaroj se përkthimi në gjuhën shqipe është bërë sipas tekstit origjinal në gjuhën italiane.

Përkthyes Ligjore e Ministrisë së Drejtësisë

(Tel. 069 26 68 647)

Manjola SULAJ

Manjola Sulaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE GJIROKASTËR
NOTER GENTIAN E. BINERI



V2023021760028364567

DATE 07/04/2023
NR REP 395

VËRTETIM PËRKTHIMI

Sot, më datë 07/04/2023, para meje Noter GENTIAN E. BINERI, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore GJIROKASTËR, me zyrë në adresën 18 SHTATORI, BLV KRYESOR, u paraqit personalisht:

PËRKTHYES:

Manjola Sulaj, atësia Sifi, amësia Drita, shtetase Shqiptare, lindur në Gorre, Lushnjë dhe banues në GJIROKASTËR, me adresë Rexhep Qosja 01980107; Nd. 6; H. 6; Ap. 11; Gjirokastër; Gjirokastër; 6001; Gjirokastër, lindur më 10/06/1977, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 035150034 dhe nr. personal H756102060, .

Përkthyesi është i licencuar nga Ministria e Drejtësisë, i cili/a më deklaroi se përktheu me përpikmëri dhe saktësi dokumentin bashkangjitur "Statut i shoqërisë Saranda Sailing shpk", nga gjuha italiane në gjuhën shqipe dhe e nënshkroi rregullisht përpara meje Noterit.

Në referim të nenit 135, i ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", në Republikën e Shqipërisë unë Noteri vërtetohet nënshkrimi i përkthyeses.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të këtij veprimi, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.



NOTER
GENTIAN E. BINERI

